



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 04
Prishtinë, më 7 mars 2011

P R O C E S \ V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 MARS 2011**

Mbledhjen e drejtoi zoti **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari, **Jakup KRASNIQI**, në fillim të mbledhjes plenare, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar në Kuvend kërkesën që në mbledhje plenare të radhës të diskutohet çështja e dialogut në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Ai ftoi kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë arsyetimin e kërkesës për debat.

Kryeministri, **Hashim Thaçi** tha se sot ndodhemi para fillimit të një procesi të domosdoshëm të bisedimeve në mes të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Për herë të parë prej përfundimit të luftës do të fillojmë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore Kosovë – Serbi, për herë të parë të barabartë, si përfaqësues të dy shteteve të pavarura dhe sovrane.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet që dialogu teknik të jetë në funksion për të mirën e të gjithë qytetarëve, stabilitetin në rajon dhe në funksion të integriteteve euro-atlantike.

Ai më tutje vuri në pah se çështjet për të cilat do të dialogohet janë të karakterit teknik dhe ka shumë të tilla, në mesin e të cilave përmendi çështjen e të zhdukurve e deri te çështjet administrative në mes dy shteteve, krejt kjo në kohën kur Republika e Kosovës si shtet është njohur nga 75 shtete të botës dhe kur çështja e statusit është temë e padiskutueshme.

Kryeministri Thaçi, në vazhdim ftoi Kuvendin që ta përkrah dialogun në mes dy shteteve dhe shfaqti gatishmërinë për ta informuar Kuvendin në mënyrë të përhershme për çdo fazë të zhvillimit dhe ecurinë e dialogut.

Duke iu referuar rëndësisë së dialogut në përgjithësi, kryeministri vuri në pah se ne nuk jemi vendi i parë që dialogojmë me një vend me të cilin kemi pasur konflikte historike dhe kemi zhvilluar luftë, sepse historia është e mbushur përplot me raste të tilla.

Procesin e dialogut e kemi filluar edhe më herët përmes kontakteve me Brukselin dhe Uashingtonin, ku kemi mbështetjen e plotë të partnerëve tanë, BE-së dhe SHBA-së, nënvizoi ai.

Në fund, kryeministri tha se e mirëpret debatin parlamentar konstruktiv dhe të arsyeshëm, ashtu siç mirëpret miratimin e konkluzioneve që do të dalin nga ky debat.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se përkrah propozimin e Qeverisë për nisjen e dialogut në mes dy shteteve. Ai tha se Grupi Parlamentar i PDK-së, ka hartuar një Projekt-rezolutë lidhur me dialogun Republika e Kosovë – Republika e Serbisë, të cilën e lexoi para deputetëve të Kuvendit.

Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se çështja për të cilën po debatohet është e rëndësishme së veçantë për Kosovën. Ai kërkoi nga Qeveria ofrimin e një platforme për dialogun Kosovë – Serbi, të dihet se çka fiton Kosova nga ky dialog dhe të kërkohej nga BE-ja që kushtet e anëtarësimit të jenë të njëjta për të dy shtetet.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se negociatat në mes Kosovës dhe Serbisë duhet të ndalen menjëherë. Ai tha se Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” ka hartuar një Projekt-rezolutë lidhur me dialogun Republika e Kosovë – Republika e Serbisë, të cilën e lexoi para deputetëve të Kuvendit.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se kur debatohet kjo çështje, para se gjithash duhet sqaruar disa pyetje, siç janë: pse tash të zhvillohen bisedime me Serbinë, pse kaq shpejt duhet bërë ato dhe, mbi të gjitha, çka fiton Kosova nga këto bisedime. Ne nuk i kemi të qarta këto gjëra, sepse Kuvendit nuk i është ofruar asnjë material se çka do të prezantojë zëvendëskryeministrja Edita Tahiri në ato bisedime, nënvizoi deputeti Gjini.

Në vazhdim, theksoi se është problematike të thuhet se çka fitojmë ne si shtet nga këto bisedime, përderisa Serbia përmes këtyre bisedimeve bën hapa drejt vendit kandidat për në BE, për të shtruar pyetjen se çfarë borgji i ka Kosova Serbisë lidhur me këto bisedime kaq të hershme?

Ibrahim Makolli, në emër të Koalicionit Kosova e Re, tha se është dashur që Qeveria t’i ofrojë Kuvendit një plan të detajuar për këto bisedime. Ai theksoi se jemi për bisedime, por duhet ta kemi të qartë se çka fiton Kosova nga ato bisedime, duhet të kemi kërkesa të qarta për Serbinë dhe kërkesa të qarta për bashkësinë ndërkombëtare rreth këtyre bisedimeve.

Serbisë duhet t’i bëhet e qartë se pa shpërbërjen e strukturave paralele në Kosovë nuk ka bisedime, konstatoi deputeti Makolli.

Sasha Rashiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se i përkrahim këto bisedime që janë në të mirë të të gjithë qytetarëve, si në Kosovë dhe në Serbi, e të cilat organizohen nën patronatin e BE-së dhe të SHBA-ve.

Rasim Demiri, në emër të Grupit Parlamentar “6+” , tha se bisedimet janë shumë të rëndësishme për stabilitetin në rajon, ndërsa vlerësoi se ka shumë çështje teknike të pazgjidhura. Ai konstatoi se vendimet nga këto bisedime duhet të jenë të pranueshme nga të dy palët, kurse çështja e statusit është temë e padiskutueshme.

Pas përfaqësuesve të grupeve parlamentare, fjalën e mori përsëri kryeministri i Qeverisë.

Hashim Thaçi, në pyetjen e shtruar më parë në debat se çka fiton Kosova, tha se nga bisedimet do të reflektojnë njohja e shtetit tonë edhe nga pesë vende anëtare të BE-së, të cilat akoma nuk e kanë njohur Kosovën, pastaj liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, përshtetimi i integritetit të vendit tonë në NATO, BE dhe anëtarësimi në OKB. Në lidhje me platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për këto bisedime, ai tha se një platformë e tillë ekziston që nga shtatori i vitit 2010, dhe të cilën ua kemi dërguar BE-së dhe SHBA-së.

Kryeministri, në vijim përmendi se Qeveria e Republikës së Kosovës në asnjë mënyrë nuk do të bisedojë për:

1. Statusin politik të Republikës së Kosovës,
2. Integritetin territorial të Republikës së Kosovës,
3. Çështjet që janë në kundërshtim me Planin gjithëpërfshirës të Ahtisarit dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Sabri Hamiti, Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Fatmir Limaj, Muhamet Musatafa, Duda Balje, Rada Trajković, Skender Hyseni, Blerim Shala, Albana Fetoshi, Myzejene Selmani, Rexhep Selimi, Lutfi Haziri, Berat Buzhala, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Emilija Rexhepi, Amir Ahmeti, Vjosa Osmani, Ramiz Lladrovci, Glauk Konjufca, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, Alma Lama, Liburn Aliu, Jakup Krasniqi, Aurora Bakalli, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, Lumnije Morina, Afrim Kasolli, Flora Brovina, Albana Gashi, Xhavit Haliti, Ganimete Musliu, Halit Krasniqi dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të paraqitura, kryetari **Jakup Krasniqi** konstatoi se Kuvendit i janë paraqitur dy projekt-rezolute, një nga Grupi Parlamentar i PDK-së dhe tjetra nga Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje”.

Ai më tej konstatoi se në Kryesi të Kuvendit jemi marrë vesh që nga ky debat të dalë një rezolutë për këtë çështje.

Kryetari propozoi që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të bashkëpunojnë me qëllim të hartimit të një projekt-rezolute të re, e cila do të bazohet mbi bazën e Projekt-rezolutës së paraqitur sot nga Grupi Parlamentar i PDK-së, mbi bazën e Projekt-rezolutës së paraqitur sot nga Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” dhe mbi bazën e pjesës së dytë të fjalës së paraqitur sot në Kuvend nga kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Kjo projekt-rezolutë t’i paraqitet Kuvendit në mbledhjen plenare të 10 marsit 2011, për votim.

Kryetari hodhi në votim propozimin për hartimin e një projekt-rezolute të re nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 45,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin që përfaqësuesit e grupeve parlamentare të hartojnë një projekt-rezolute të re, e cila do të bazohej mbi bazën e Projekt-rezolutës së paraqitur sot nga Grupi Parlamentar i PDK-së, mbi bazën e Projekt-rezolutës së paraqitur sot nga Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” dhe mbi bazën e pjesës së dytë të fjalës së paraqitur sot në Kuvend nga kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kjo projekt-rezolutë ti paraqitet Kuvendit në mbledhjen plenare të 10 marsit 2011, për miratim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 17 : 55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale.